

		ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Mjeshi:		Nr. Prot.:	
Uniti:	KO	Prot. No.:	08/2022
Jedinita:		Er. Prot.:	
Nr. i faqeve:		Data:	28.01.2022
No. of pages:	-26-	Datum:	
Er. strania:			



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

STATUTI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

Janar 2022

Prishtinë

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 2, paragrafit 1, nenit 5, paragrafëve 1 dhe 4, nenit 6, nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1, në lidhje me nenin 48 të Ligjit nr. 04/L-150 për Odat e profesionistëve shëndetësorë, Oda e Mjekëve të Kosovës, në mbledhjen e datës 10 janar 2018, mbledhjen e datës 17 janar 2019 si dhe përmes votimit elektronik të datës 27 janar 2022, miraton plotësimet dhe ndryshimet e Statutit të miratuar më datë 26 janar 2015:

S T A T U T I

I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. KO 07/2022 të Kuvendit të OMK-së, datë 27 janar 2022)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Oda e Mjekëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: OMK-së) është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

Neni 2

OMK-ja anëtarëve të saj u siguron standarde të larta të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e mjekëve në institucionet shëndetësore publike, private, si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve të tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Neni 3

Me Statutin e OMK-së rregullohen emërtimi, selia dhe organizimi i brendshëm, anëtarësia, kompetencat, organizimi dhe funksionimi, mbajtja e regjistrit të anëtarëve, organet e saj, mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve, përbërja dhe kompetencat e organeve të saj, përgjegjësia disiplinore e anëtarëve, procedurat para Këshillit Etik dhe Gjyqit të Nderit, burimet e financimit dhe çështje të tjera me rëndësi për punën dhe funksionimin e OMK-së.

Neni 4

1. OMK-ja ka statusin e personit juridik me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë të parapara me Ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë dhe me këtë Statut.
2. OMK-ja do të veprojë në emër të vet dhe do të jetë përgjegjëse për detyrimet e veta me të gjitha pasuritë e saj.

II. EMËRTIMI DHE SELIA

Neni 5

1. Emërtimi i OMK-së është: Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK).
2. Selia e OMK-së është në Prishtinë.
3. Akronimi “ OMK “ përdoret në gjuhët zyrtare dhe gjuhën angleze.

Neni 6

1. OMK-në e përfaqëson kryetari i Odës.
2. Në mungesë të kryetarit OMK-në e përfaqëson njëri nga zëvendëskryetarët e OMK-së

Neni 7

1. OMK-ja e ka vulën e vet të rrumbullakët, të dimensionit 30 mm, e cila përmban tekstin në gjuhët zyrtare "Republika e Kosovës - Oda e Mjekëve të Kosovës - Prishtinë" dhe simbolin zyrtar të OMK-së me akronimin nën simbol.
2. OMK-ja mban edhe vulën katrore të madhësisë 50 x 25 mm, me përmbajtje të tekstit nga paragrafi 1 i këtij neni dhe hapësirën për evidentimin e numrit dhe të datës së lëshimit të aktit.
3. Mënyra e përdorimit dhe e ruajtjes së vulës së rrumbullakët dhe të asaj katrore rregullohet me akt të veçantë të OMK-së, i cili do të përpilohet nga organet e OMK-së në afat prej 30 ditësh nga data e miratimit të këtij Statuti.

Neni 8

1. OMK-ja e ka simbolin e vet zyrtar .
 - 1.1 Simboli zyrtar i OMK-së është emblema e saj.
2. Simboli i OMK-së gëzon mbrojtje ligjore.

III. ANËTARËSIMI NË OMK

Neni 9

1. Anëtarësimi në OMK është obligues për të gjithë doktorët e mjekësisë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës.
2. Anëtarësimi në OMK është obligues edhe për të gjithë doktorët, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kushte të mbrojtjes sociale, institucione tjera të organeve shtetërore, në fakultete, gjegjësisht në shkolla profesionale, në ambulanca të mjekësisë së punës, si dhe në të gjitha rrethanat e tjera ku ushtrohet veprimtaria shëndetësore në përputhje me ligjet në fuqi.
3. Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të mjekut në Republikën e Kosovës, detyrohen/obligohen të anëtarësohen paraprakisht në OMK, të njohin dhe të zbatojnë Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore të Kosovës, si dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Neni 10

1. Statusi i anëtarit të OMK-së fitohet me regjistrimin në regjistrin qendror të OMK-së.
2. Organet kompetente të OMK-së në afat prej 15 ditësh, nga dita e paraqitjes së kërkesës nga mjeku, lëshojnë vendim me të cilin lejohet ose refuzohet regjistrimi në regjistrin e mjekëve.
3. Ndaj vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni mund t'i ushtrohet ankesa organit kompetent në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit.
4. Kushtet për anëtarësim:
 - 4.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 4.2. Të ketë diplomën e mjekut, mjekut specialist, diplomën e subspecializimit të lëshuar nga Fakulteti i Mjekësisë ose nga organet kompetente të licencuara në Republikën e Kosovës (universitete, institute, shkolla të larta brenda apo jashtë shtetit);
 - 4.3. Për ata mjekë që janë diplomuar jashtë shtetit, këto dokumente duhet t'i kenë të njësuara (barasvlershme) nga institucioni përgjegjës - Republika e Kosovës;
 - 4.4 Kopja e noterizuar e licencës valide të punës;
 - 4.5 Kërkesën për anëtarësim, në të cilën shprehet se njih aktet ligjore e nënligjore në fuqi, Statutin e OMK-së, Betimin e Mjekut, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, dhe se do t'i respektojë ato me përpikëri sipas formularit standard të miratuar nga OMK-ja;
 - 4.6 Fotokopje të diplomës, të vërtetuar te noteri;
 - 4.7 Fotokopjen e certifikatës/ave të specializimit të vërtetuara tek noteri; dhe

4.8 3 (tri) fotografi 3x4 cm.

5. Mjekut shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Kosovë dhe të jetë i anëtarësuar apo i atashuar në një institucion shëndetësor ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, i duhet përveç kushteve të përcaktuara me nenin 10, paragrafin 4, nënparagrafët 4.2, 4.3, 4.4, 4.5, 4.6, 4.7 dhe 4.8, të ketë edhe:

5.1. Leja e qëndrimit në Republikën e Kosovës sipas Ligjit nr. 03/L-126;

5.2 Vërtetim nga Oda e Mjekëve të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin, se nuk ka marrë masa ndëshkimore, dhe të mos të jetë në ndjekje penale;

5.3 Njësimi (barasvlera) e diplomës dhe certifikatave të specializimeve të kryera prej tij/saj të përkthyer dhe të vërtetuara te noteri;

5.4 Mjeku i huaj rezident në Kosovë të njohë gjuhët zyrtare, të vërtetuar me dëshmi nga autoriteti gjegjës; dhe

5.5 Për mjekun jorezident detyrimisht të punojë me përkthyes të licencuar.

6. Mjekët e pensionuar, të cilët mund të anëtarësohen në OMK, ata të cilët nuk e ushtrojnë profesionin mjekësor, lirohen nga pagesa e anëtarësisë, kurse ata që ushtrojnë profesionin mjekësor u nënshtrohen të gjitha kriterëve dhe obligimeve për anëtarësim.

7. Mjekët me shtetësi të Republikës së Kosovës, të cilët ushtrojnë veprimtarinë shëndetësore jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe që shprehin vullnetin të regjistrohen dhe të anëtarësohen në Odë, mund të paraqesin kërkesën e tyre për regjistrim në pajtim me kushtet siç janë paraparë me dispozitat e këtij neni përkitazi me regjistrimin dhe anëtarësimin e mjekëve vendës.

Neni 11

Rianëtarësimi

Mjekët që për arsye të ndryshme janë larguar nga OMK-ja kanë të drejtë rianëtarësimi pas përmbushjes së obligimeve dhe detyrimeve që rregullohen me akt të veçantë.

Neni 12

Për veprimet e kryera për regjistrim-anëtarësim dhe leje ushtrimi profesioni, kërkuesi paguan tarifatat të cilat përcaktohen me vendim të Kuvendit të OMK-së.

Neni 13

1. Në realizimin e kompetencave dhe detyrave të OMK-së, anëtarët të OMK-së kanë këto të drejta:

- 1.1. Të ushtrojnë veprimtarinë shëndetësore për të cilën janë licencuar;
- 1.2. Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e OMK-së;
- 1.3. Të informohen për të gjitha çështjet e punës dhe afarizmit të OMK-së;
- 1.4. Që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet përfaqësuesve të vet të japin propozime dhe të shprehin mendimin e tyre për mbrojtjen e interesave dhe të integritetit personal dhe të përgjithshëm në ushtrimin e veprimtarisë mjekësore;
- 1.5. Të shfrytëzojnë ndihmën materiale të OMK-së nga fondi i veçante i solidaritetit, nën kushtet dhe procedurat e parapara me akte të veçanta të OMK-së.
- 1.6. Të shfrytëzojnë të drejta tjera të parapara me akte të veçanta të OMK-së.
- 1.7. Të apelojnë në organet e OMK-së kur u shkelen të drejtat dhe mundësitë për ushtrim autonom të lirë dhe të pavarur të profesionit nga cilido qoftë.
- 1.8 Të kërkojnë krijimin e kushteve të favorshme për ushtrimin normal të profesionit, për edukimin e vazhdueshëm profesional dhe përparimin në karrierë.

Neni 14

1. Anëtarët e Odës kanë këto obligime dhe përgjegjësi:

- 1.1. Të respektojnë Statutin e OMK-së dhe Kodin e Etikës profesionale;
- 1.2. Të paguajnë anëtarësinë e OMK-së në mënyrë të rregullt;
- 1.3. Të marrin pjesë rregullisht dhe t'i kryejnë obligimet në organet e OMK-së në të cilat janë zgjedhur;
- 1.4. Të respektojnë standardet dhe normat profesionale të shërbimit shëndetësor që në mënyrë permanente të përfshihen në edukimin e vazhdueshëm profesional;
- 1.5. Të përmbushin obligimet dhe përgjegjësitë e tjera të parapara me akte të veçanta të OMK-së.

Neni 15

1. Anëtarësimi në OMK i ndërpritet në këto raste:

- 1.1. Me revokimin e përhershëm të licencës;
- 1.2. Në bazë të kërkesës së anëtarit të OMK-së, anëtarësimi ndërpritet nga dita e marrjes së vendimit nga organi kompetent i OMK-së për çregjistrim nga regjistri i anëtarëve të OMK-së;

- 1.3. Në raste të humbjes së zotësisë së veprimit në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjyqësorit të OMK-së;
- 1.4. Në raste të mospagesës së anëtarësisë në vazhdimësi gjashtë muaj;
- 1.5. Në rast të vdekjes së anëtarit të OMK-së.

Neni 16

Anëtarit të OMK-së që i është ndërprerë anëtarësia është i obliguar që në afat prej 7 ditësh t'ia dorëzojë OMK-së kartelën e anëtarësimit, në të kundërtën OMK-ja e paraqet në Këshillin Etik për fillimin e procedurës për shkelje të legjislacionit në fuqi.

IV. KOMPETENCAT E OMK-së

Neni 17

1. Kompetencat publike të Odës janë:

- 1.1. Miraton Kodin e Etikës profesionale (Kodin e Etikës);
- 1.2. Regjistron dhe mirëmban regjistrin e mjekëve dhe të gjitha institucioneve shëndetësore;
- 1.3. Lëshon licenca të mjekëve, rilicencimin dhe revokimin e licencave;
- 1.4. Zbatimin e mbikëqyrjes profesionale me angazhim të ekspertëve të lëmenjve përkatës;
- 1.5 Mbikëqyrjen e funksionimit ligjor të institucioneve nga nenet 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për Shëndetësi.
- 1.6. Bashkëpunimi me organet shtetërore që adresojnë çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit;
- 1.7. Ushtron mbikëqyrjen e punës profesionale shëndetësore dhe ligjore për punën e mjekëve.
- 1.8. Planifikon dhe zbaton edukimin e vazhdueshëm profesional;
- 1.9. Ndërmjetëson në kontestet në mes anëtarëve të OMK-së dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore;
- 1.10. Organizon gjyqet e nderit në lidhje me përcaktimin e shkeljeve dhe obligimeve profesionale të anëtarëve të OMK-së dhe shqipton masa disiplinore;
- 1.11. Cakton lartësinë e anëtarësisë të anëtarëve të OMK-së;

1.12. Cakton lartësinë e taksës për licencim, rilicencim dhe lejeve të tjera për ushtrim të veprimtarisë profesionale, në bazë të autorizimeve ligjore;

1.13. Lëshon kartelat e identifikimit dhe numrat identifikues për anëtarët e OMK-së.

1.14. Me kërkesën e anëtarëve të OMK-së lëshon certifikata, vërtetime dhe dokumente tjera në bazë të evidencës zyrtare të OMK-së.

Neni 18

Përgjegjësitë publike organet e OMK-së i ushtrojnë sipas procedurës së paraparë me Ligjin mbi procedurën e përgjithshme administrative.

Neni 19

Kompetencat e tjera të OMK-së

1. Përveç autorizimeve publike nga neni 9 i Ligjit mbi odat e profesionistëve shëndetësorë, dhe nenit 17 të këtij Statuti, OMK-ja ushtron edhe këto detyra:

1.1. Përfaqëson dhe mbron interesat profesionale të anëtarëve të OMK-së në ushtrimin e profesionit;

1.2. Kujdeset për ruajtjen e autoritetit të anëtarëve të OMK-së në ushtrimin e punëve profesionale në pajtim me etikën profesionale;

1.3. Mban evidencën e anëtarëve të OMK-së që ushtrojnë veprimtarinë publike, private dhe publiko-private shëndetësore, dhe të cilët janë të regjistruar në regjistrin e organit kompetent në pajtim me ligjin;

1.4. Bashkëpunimi në përgatitjen e ligjeve, dokumenteve, si dhe akteve të tjera nënligjore në sektorin e shëndetësisë, si dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre;

1.5. Propozimi dhe inicimi i procedurave për nxjerrjen e akteve të përgjithshme dhe të veçanta në përputhje me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të OMK-së;

1.6. Përcaktimi i çmimoreve të shërbimeve shëndetësore në bashkëpunim me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore dhe shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore;

1.7. Bashkëpunimi me sektorët e shëndetësisë në përpilimin e planprogrameve për edukimin e vazhdueshëm profesional për të gjithë mjekët;

- 1.8. Zbatimi i aktiviteteve shkencore dhe hulumtuese në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e OMK-së;
- 1.9. Përfaqësimi i interesave profesionale dhe sociale të mjekëve;
- 1.10. Konsultimi, ofrimi i ndihmës dhe përfaqësimi i interesave të anëtarëve të OMK-së në fushën e legjislacionit, si dhe lëmenjve të tjera që ndërlidhen me fushën e shëndetësisë;
- 1.11. Pjesëmarrja në vendimmarrje në lidhjen e kontratave me Fondin për Sigurime Shëndetësore;
- 1.12. Krijimi dhe menaxhimi i fondit të OMK-së;
- 1.13. Bashkëpunon me organet kompetente në parandalimin e veprimtarisë shëndetësore ilegale;
- 1.14. Përgatitja dhe lëshimi i formave dhe dokumenteve, si dhe i revistave, librave dhe publikimeve të tjera;
- 1.15. Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të OMK-së;
- 1.16. Zbatimi i aktiviteteve të tjera në përputhje me Ligjin, këtë Statut dhe aktet e tjera të përgjithshme të OMK-së.

V. ORGANET E ODËS

Neni 20

1. Organet e OMK-së janë:

- 1.1. Kuvendi;
- 1.2. Kryetari i OMK-së;
- 1.3. Këshilli Drejtues;
- 1.4. Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së;
- 1.5. Këshilli Etik;
- 1.6. Gjyqi i Nderit;
- 1.7. Prokurori i OMK-së;
- 1.8. Komisionet e përhershme të OMK-së.

2. Mandati i anëtarëve të organeve të OMK-së është 4 vjet, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër katërvjeçar.
3. Kompensimi i shpenzimeve materiale të OMK-së, si dhe kompensimi për punë të anëtarëve të OMK-së përcaktohet me akte të veçanta normative të OMK-së të aprovuar nga Kuvendi i OMK-së, të cilat duhet miratuar më së largu 30 ditë pas aprovimit të Statutit.
4. Mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të organeve të OMK-së përcaktohet me rregullore të veçantë, në votim për kryetar/e nga paragrafi 1 i këtij neni, nënparagrafët 1.2; 1.5; 1.6 dhe 1.7, duhet të jenë së paku dy kandidatura.

Neni 21

Kuvendi i Odës

1. Kuvendi është organi më i lartë i Odës, i cili ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë të parapara me ligj dhe këtë Statut.
2. Mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Kuvendit të Odës përcaktohet me Rregulloren mbi procedurat e kandidimit dhe revokimit të anëtarëve të Kuvendit të Odës dhe të organeve të tjera të Odës.
3. Anëtarët e Kuvendit të OMK-së zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë në njësitë zgjedhore të përcaktuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor i OMK-së.
4. Institucionet publike shëndetësore të nivelit parësor në çdo 50 anëtarë të regjistruar zgjedhin një anëtar për Kuvendin e OMK-së.
5. Institucionet publike shëndetësore të nivelit dytësor në çdo 35 anëtarë të regjistruar zgjedhin një anëtar për Kuvendin e OMK-së.
6. Institucionet publike të nivelit terciar në çdo 25 anëtarë të regjistruar zgjedhin një anëtar për Kuvendin e OMK-së.
7. Institucionet private shëndetësore do të përfaqësohen në Kuvendin e OMK-së sipas mënyrës së përcaktuar me aktin normativ lidhur me zgjedhjet e brendshme të Odës.
8. Institucionet e mbrojtjes sociale, shërbimet korrektuese të Kosovës, FSK-ja, delegojnë nga një anëtar në Kuvendin e OMK-së.
9. Mjekët nga diaspora të organizuar përmes shoqatave profesionale delegojnë 5 anëtarë në Kuvendin e OMK-së.

10. Me qëllim të formimit më të lehtë të njësive zgjedhore shmangiet nga kriteret e numrit të mjekëve të regjistruar në institucionet publike dhe private mund të jenë $\pm 5 \%$, të cilin e përcakton Komisioni zgjedhor i OMK-së.

Neni 22

Kompetencat e Kuvendit

1. Kuvendi është organi më i lartë i OMK-së, i cili ka këto përgjegjësi dhe autorizime:

- 1.1. Miraton, ndryshon dhe plotëson Statutin dhe aktet e tjera normative;
- 1.2. Miraton Kodin e Etikës profesionale;
- 1.3. Miraton programin e punës së OMK-së;
- 1.4. Miraton, ndryshon dhe plotëson Rregulloren e punës së OMK-së;
- 1.5. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin;
- 1.6. Zgjedh, miraton dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues të OMK-së;
- 1.7. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin, zv. kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Etik;
- 1.8. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës;
- 1.9. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët e Gjyqit të Nderit;
- 1.10. Zgjedh dhe shkarkon prokurorin e OMK-së;
- 1.11. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët e komisioneve të përhershme të OMK-së;
- 1.12. Përcakton lartësinë e anëtarësisë për anëtarët e OMK-së;
- 1.13. Përcakton rregulloren për lartësinë e kompensimit (taksës) për anëtarët e OMK-së, taksën për licencim dhe rilicencim, si dhe lartësinë e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve të tjera për të cilat OMK-ja mban evidencë zyrtare;
- 1.14. Përcakton lartësinë e kompensimit për regjistrimin, në regjistrin e anëtarëve të OMK-së;
- 1.15. Shqyrton dhe miraton raportet e punës së organeve të OMK-së;
- 1.16. Miraton raportin vjetor të OMK-së;
- 1.17. Miraton raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare të OMK-së;
- 1.18. Miraton raportin mbi punën e Këshillit Drejtues të OMK-së;

- 1.19 Merr vendim për shpërndarje të Kuvendit të OMK-së dhe shpall zgjedhjet e parakohshme;
- 1.20 Vendos për anëtarësim të OMK-së në organizatat ndërkombëtare simotra, merr vendime për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve të OMK-së;
- 1.21 Shqyrton dhe merr qëndrime parimore për çështjet me rëndësi për punën e OMK-së.

Neni 23

1. Mbledhjet e Kuvendit të OMK-së janë publike dhe mund të mbahen nëse janë prezentë më shumë se gjysma e anëtarëve, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit të OMK-së.
2. Mbledhjen e Kuvendit të OMK-së e udhëheq kryetari i OMK-së.
3. Votimi për pikat e rendit të ditës është i hapur, përveç në raste kur Kuvendi vendos ndryshe.
4. Statuti i OMK-së, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij miratohen me votimin e 2/3 të anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit të OMK-së.
5. Vendimet e tjera Kuvendi i merr me shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezentë.

Neni 24

Me Rregulloren mbi Punën e Kuvendit të OMK-së përcaktohen mënyra e konvokimit (thirrjes) të mbledhjeve të Kuvendit, e udhëheqjes së mbledhjes së saj, mënyra e marrjes së vendimeve, dhe çështje tjera procedurale dhe teknike për mbarëvajtjen e mbledhjeve të Kuvendit.

Neni 25

1. Me propozim të Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës, ose 1/4 e anëtarëve të Kuvendit të OMK-së, kryetari i OMK-së është i obliguar të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të OMK-së në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të propozimit.
2. Nëse nuk thirret mbledhja e Kuvendit sipas paragrafit 1, atëherë propozuesit e thërrasin mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit.
3. Propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të formulohet me shkrim së bashku me materialin e rendit të ditës, që duhet t'i dërgohet zyrës së kryetarit përmes sekretarit të OMK-së

Neni 26

Kryetari i OMK-së

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të OMK-së:

- 1.1. Përfaqëson OMK-në dhe vepron në emër të saj;
- 1.2. Fton dhe udhëheq seancat e Kuvendit;
- 1.3. Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të OMK-së;
- 1.4. Kryetari i OMK-së është edhe anëtar i Këshillit Drejtues;
- 1.5. Ekzekuton aktet e Kuvendit të OMK-së;
- 1.6. Ia propozon Kuvendit të OMK-së emërimin dhe shkarkimin e zëvendësve të tij/saj;
- 1.7. Organizon punën dhe drejton politikën e OMK-së;
- 1.8. Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e OMK-së;
- 1.9. Raporton para Kuvendit të OMK-së për situatën ekonomiko-financiare të OMK-së së paku një herë në vit apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i OMK-së;
- 1.10. Aktivitete të tjera që i caktohen me akte të veçanta.
- 1.11. Në rast të mungesës, kryetarin e OMK-së e zëvendëson njëri nga zv. kryetarët e OMK-së.
- 1.12. Kryetari jep informata për publik ose e autorizon një anëtar tjetër të OMK-së.

Neni 27

Kryetari dhe nënkryetarët e OMK-së mund t'i kryejnë punët e veta sipas kontratës për punë, e cila mundet me qenë me orar të plotë, me orar të pjesshëm ose me kompensim të caktuar.

Neni 28

Kryetari i OMK-së, zëvendëskryetarët, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe sekretari i përgjithshëm nuk mund të jenë persona të zgjedhur dhe të emëruar në funksione të tjera publike dhe politike, përveç profesionale mjekësore dhe në mësimdhënie.

Neni 29

Kryetarin e OMK-së e zgjedh Kuvendi i OMK-së në pajtim me Rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OMK-së dhe organeve të tjera në pajtim me Statutin.

Neni 30

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues i OMK-së ka njëmbëdhjetë (11) anëtarë nga të cilët një (1) anëtar i komunitetit joshumicë dhe një (1) anëtar nga radhët e komuniteteve të tjera.
2. Kryetari dhe zëvendëskryetarët e OMK-së janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.
3. Pesë (5) anëtarë të Këshillit Drejtues i zgjedh Kuvendi i OMK-së nga radha e anëtarëve të vet, ndërsa tre (3) anëtarë të Këshillit Drejtues i delegon Ministria e Shëndetësisë.
4. Mënyra e punës së Këshillit Drejtues më hollësisht rregullohet me rregullore të punës.
5. Sekretari i përgjithshëm i OMK-së është person i ftuar gjithmonë në takimet e Këshillit Drejtues.
6. Sekretari i përgjithshëm i OMK-së nuk ka të drejtë vote, por ka të drejtë për të propozuar pika në rendin e ditës dhe dokumentet mbështetëse të tyre.

Neni 31

1. Këshilli Drejtues i OMK-së:

- 1.1. Është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të OMK-së;
- 1.2. Përcakton propozimin e Statutit dhe akteve të tjera të OMK-së;
- 1.3. Ia propozon Kuvendit anëtarët e organeve të OMK-së;
- 1.4. Përcjell dhe harmonizon punën e organeve të OMK-së;
- 1.5. Përcakton propozimin e programit të punës të OMK-së;
- 1.6. Ua propozon organeve shtetërore masat për mbrojtjen dhe përparimin e mbrojtjes shëndetësore dhe të sigurimit shëndetësor;
- 1.7. Përcakton planin financiar të OMK-së dhe kujdeset për zbatim;
- 1.8. Miraton llogaritë periodike financiare;
- 1.9. Këshilli Drejtues emëron sekretarin e përgjithshëm njërin nga kandidatët e përzgjedhur me konkurs publik, dhe e shkarkon të njëjtin sipas procedurave të parapara;

1.10. Shqyrton dhe miraton raportet periodike të punës së OMK-së në fushat për të cilat është përgjegjës;

1.11. Miraton rregulloren mbi organizimin dhe sistematizim e punëve të shërbimit profesional të OMK-së dhe merr masa për sigurimin e ligjshmërisë dhe efikasitetin e punës së shërbimit profesional;

1.12. Vendors në shkallë të dytë sipas ankesave nga marrëdhënia e punës të punëtorëve të shërbimit profesional të OMK-së; dhe

1.14. Kryen edhe punë tjera të parapara me akte të veçanta.

2. Kompensimi për punën e Këshillit Drejtues rregullohet me akte të veçanta.

Neni 32

1. Këshilli Drejtues merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të tij.

2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat katër vjet dhe përputhet me mandatin e anëtarëve të Kuvendit.

3. Kryetari i Këshillit Drejtues zgjidhet nga anëtarët e Këshillit Drejtues me shumicë votash.

4. Mbledhjet e Këshillit Drejtues i udhëheq kryetari i Këshillit Drejtues.

5. Pikat e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit Drejtues dhe materialet lidhur me to i përgatit kryetari i Këshillit Drejtues në bashkëpunim me sekretarin e përgjithshëm të OMK-së.

6. Këshilli Drejtues mban mbledhje të rregullta së paku një herë në muaj.

7. Në mungesë të kryetarit të Këshillit Drejtues, mbledhjet e Këshillit Drejtues i udhëheq zëvendëskryetari i Këshillit Drejtues.

8. Zëvendëskryetari i Këshillit Drejtues propozohet nga kryetari i Këshillit Drejtues dhe zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

9. Këshilli Drejtues për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të OMK-së.

10. Mënyra e punës së Këshillit Drejtues përcaktohet me rregullore të punës të Këshillit Drejtues.

11. Këshilli Drejtues i paraqet raport me shkrim Kuvendit për punën e tij së paku dy herë në vit apo sa herë që kërkon Kuvendi me $\frac{1}{4}$ e anëtarëve.

Neni 33
Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së

1. Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së:

- 1.1. Mbikëqyr dhe përcjell afarizmin financiar të OMK-së;
- 1.2. Përcjell dhe mbikëqyr realizimin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve të OMK-së;
- 1.3. Mbikëqyr dhe përcjell punën e Shërbimit profesional të OMK-së;
- 1.4. I propozon Këshillit Drejtues marrjen e masave dhe veprimeve në rastet kur vlerëson se ka shkelje ligjore dhe të akteve të miratuara nga Kuvendi i OMK-së;
- 1.5. Kryen edhe punë të tjera të parapara me akte të veçanta.

2. Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së përbëhet nga shtatë (7) anëtarë.

3. Kryetarin, zëvendëskryetarin dhe tre (3) anëtarë të tjerë të Këshillit i zgjedh Kuvendi i OMK-së nga radha e anëtarëve të vet, ndërsa dy (2) anëtarë i delegon Ministria e Shëndetësisë.

4. Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të OMK-së.

5. Kryetarin, zv. kryetarin dhe anëtarët e tjerë të Këshillit i zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve të vet, në pajtim me Rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OMK-së dhe organeve të tjera.

Neni 34
Këshilli Etik

1. Këshilli Etik:

- 1.1. Mbikëqyr zbatimin e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;
- 1.2. Siguron udhëheqjen etiko-morale e deontologjike dhe promovon principet dhe parimet e etikës profesionale;
- 1.3. Merr masat e duhura në rast të shkeljes së Kodit Etik dhe të Deontologjisë Mjekësore;
- 1.4. Pranon dhe shqyrton ankesat nga ana e qytetarëve;
- 1.5. Fillimi i procedurës në Këshillin Etik nuk mund të fillojë më vonë se 9 (nëntë) muaj nga dita e shkeljes së supozuar të Kodit Etik dhe të Deontologjisë Mjekësore.
- 1.6. Këshilli Etik pas marrjes së ankesës brenda 60 ditësh duhet të dalë me vendim.

1.7. Jep mendimet dhe vlerësimet për punën e anëtarëve të OMK-së në pajtim me Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;

1.8. U ofron mbështetje qytetarëve në realizimin e së drejtës së cilësisë së shërbimeve, llojit dhe përmbajtjes së tyre;

1.9. Kryen dhe pune tjera të parapara me Statut të OMK-së, si dhe me akte të veçanta të OMK-së.

2. Këshilli Etik ka pesë anëtarë.

3. Kryetarin, zëvendëskryetarin dhe dy anëtarët e tjerë të Këshillit Etik i zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve të Odës, në pajtim me Rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Odës dhe organeve të tjera, ndërsa një anëtar e delegon Ministria e Shëndetësisë.

Neni 35

Masat disiplinore

1. Këshilli Etik është organ i shkallës së parë, i cili fillon procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së mjekëve për shkelje të Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë, Statutit të OMK-së dhe Kodit të Etikës mjekësore dhe varësisht nga shkeljet e konstatuara shqipton këto masa disiplinore:

1.1. Rekomandim kolegjal;

1.2. Kërkim falje ndaj pacientit;

1.3. Qortim ose qortim publik,

1.4. Arsimit plotësues (shtesë) të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim;

1.5. Trajtimi i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe vese të tjera;

1.6. Tërheqja e përkohshme ose e përhershme e licencës, ose fshirja e mjekut nga registri; ose

1.7. Dënimi me të holla prej 1 000 deri në 3 000 euro për çdo shkelje të ligjit, detyrave profesionale dhe etike.

Neni 36

1. Në procedurë para Këshillit Etik të OMK-së zbatohen dispozitat dhe rregullat e procedurës së përgjithshme administrative, në lidhje me thirrjen e palëve, mbi sigurimin e provave, procesverbalin, dëgjimin e palës dhe procedurave të tjera.

2. Anëtarit të OMK-së ndaj të cilit është filluar procedura disiplinore doemos duhet t'i mundësohen deklarimi dhe mbrojtja në Këshillit Etik.
3. Në procedurën e marrjes në pyetje të anëtarëve të OMK-së dhe vlerësimit të provave në procedurën disiplinore para Këshillit Etik mbahet procesverbali.
4. Sipas ankesës ndaj vendimit të Këshillit Etik vendos Gjyqi i Nderit.
5. Deri në vërtetësinë e dyshimit të bazuar anëtari i OMK-së, i cili është në procedurë, është i pafajshëm dhe i gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara me Statut të OMK-së.

Neni 37

1. Fillimi i procedurës para Gjyqit të Nderit për përcaktimin e shkeljeve të anëtarit të OMK-së nga neni 35 i këtij Statuti, paragrafët 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7, nuk mund të fillojë pas skadimit të një viti nga dita e shkeljes profesionale dhe shkeljes së nderit të anëtarit të OMK-së.
2. Procedura në shkallë të parë në Gjyqin e Nderit, dhe kur vendos në shkallë të dytë sipas mjetit juridik (ankesës) me të cilin është goditur vendimi i shkallës së parë, nuk mund të zgjasë më tepër se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga dita e parashtrimit nga ana e palës që e ka parashtruar atë.

Neni 38

Kriteret për përcaktimin e shkeljeve, procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë të mjekut për shkelje të këtij Statuti dhe Kodit të Etikës mjekësore, përcaktohen me akte të veçanta.

Neni 39

Gjyqi i Nderit

1. Gjyqi i Nderit është organ i OMK-së që ushtron funksionet e përcaktuara me Ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë me këtë Statut dhe aktet e tjera normative të OMK-së.
2. Gjyqi i Nderit ushtron funksionin e vet në mënyrë të pavarur dhe duke u bazuar në Ligjin mbi odat e profesionistëve shëndetësorë, këtë Statut dhe aktet e tjera normative të OMK-së.

Neni 40

Ndaj vendimit përfundimtar me të cilin është shqiptuar masa disiplinore nga neni 35 i këtij Statuti, paragrafët 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7, mjekët mund të ushtrojnë ankesë në Gjyqin e Nderit të OMK-së.

Neni 41

Gjyqi i Nderit vendos edhe lidhur me ankesat e anëtarëve të Odës dhe parregullsive në procesin e zgjedhjeve të organeve të OMK-së.

Neni 42

1. Gjyqi i Nderit ka pesë anëtarë, kryetarin, zëvendësin e tij dhe tre anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i OMK-së, në pajtim me Rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OMK-së dhe organeve të tjera.
2. Një anëtar dhe zëvendësin e tij e propozon Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 43

Prokurori i OMK-së

Prokurori i Odës është organ i pavarur për iniciimin e procedurës ndaj anëtarëve të Odës, ndaj të cilëve ekziston dyshimi i bazuar se ka bërë shkelje të Ligjit, Statutit dhe Kodit të Etikës Mjekësore.

Neni 44

Rastet e shkeljes nga neni 35 i këtij Statuti mund t'i denoncojnë: OMK-ja, Ministria e Shëndetësisë, shoqatat e profesionistëve shëndetësorë, shoqatat e mjekëve, institucionet shëndetësore, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Prokuroria Shtetërore, anëtarët e OMK-së dhe pala që konsideron të jetë e dëmtuar.

Neni 45

1. Prokurorin dhe zëvendësin e tij i zgjedh Kuvendi i OMK-së nga radha e anëtarëve të OMK-së, në pajtim me Rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OMK-së dhe organeve të tjera.
2. Prokurori i OMK-së për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të OMK-së.

Neni 46

Komisionet e përhershme

(Ndryshuar me Vendimin nr. 47/2018 të Kuvendit të OMK-së, datës 10 janar 2018)

Anëtarët e komisioneve të përhershme të OMK-së i zgjedh Kuvendi i OMK-së nga radha e anëtarëve të OMK-së në pajtim me Rregulloren e miratuar mbi procedurat e kandidimit dhe zgjedhjes së anëtarëve në organet e OMK-së.

Neni 47

1. Komisionet e përhershme të OMK-së janë:
 - 1.1. Komisioni për çështje etike;

- 1.2. Komisioni për licencim;
- 1.3. Komisioni për edukim specialistik;
- 1.4. Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
- 1.6. Komisioni për buxhet dhe financa;
- 1.7. Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.

Neni 48

(Ndryshuar me Vendimin nr. KO 07/2022 të Kuvendit të OMK-së, datës 27 janar 2022)

- 1. Komisionet e përhershme të OMK-së përbëhen nga 7 anëtarë, nga radhët e të cilëve zgjidhet kryesuesi dhe zv. kryesuesi i Komisionit.
- 2. Anëtarët e komisioneve të përhershme të OMK-së mund të jenë anëtarë vetëm në një komision të përhershëm.
- 3. Mbledhjet e komisioneve të përhershme i fton dhe i udhëheq kryetari i Komisionit.
- 4. Komisionet e përhershme së paku 2 herë në vit i raportojnë për punën e tyre Këshillit Drejtues dhe Kuvendit të OMK-së.
- 5. Mandati i anëtarëve të komisioneve të përhershme të OMK-së zgjat katër vjet dhe përputhet me mandatin e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 49

Përbërja dhe fushëveprimi i komisioneve nga neni 47 i këtij Statuti përcaktohen me akte të veçanta normative.

Neni 50

Komisionet e përkohshme

- 1. Kuvendi i OMK-së sipas nenit 37 të Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë mund të formojë edhe komisione të tjera të përkohshme.
- 2. Me vendim për formimin e komisionit/ve të përkohshme, Kuvendi i OMK-së përcakton përbërjen dhe fushëveprimin e komisionit/ve të përkohshme.

Neni 51

Bordet ekzistuese në Ministrinë e Shëndetësisë, që kanë në kompetencë dhe përgjegjësi: çështjet e etikës profesionale, të regjistrimit dhe licencimit, të edukimit të vazhdueshëm profesional dhe të edukimit specialistik, vazhdojnë së funksionuari gjer në formimin e komisioneve dhe akteve nënligjore nga OMK-ja.

VI. BURIMET E FINANCIMIT TË ODES

Neni 52

1. Financimi i OMK-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës në pajtueshmëri me nenin 38, paragrafin 1 të Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë, e më së largu 3 vjet nga dita e miratimit të ligjit, do të bëhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, respektivisht nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë.
2. Ministria e Shëndetësisë në planifikimet buxhetore do të marrë parasysh shpenzimet reale të OMK-së bazuar edhe në dinamikën e bartjes së përgjegjësi.

Neni 53

1. OMK-ja realizon të hyra vetjake nga:
 - 1.1. Anëtarësia;
 - 1.2. Taksa për licencim, rilicencim, lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve të tjera për të cilat Oda mban evidencë zyrtare;
 - 1.3. Dhuratat, donacionet e tjera dhe të hyrat e tjera në pajtim me ligjet në fuqi.
 - 1.5 Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore).

Neni 54

1. Anëtarët e OMK-së kanë obligim që në mënyrë të rregullt të paguajnë anëtarësinë, kompensimin për regjistrim, licencim dhe shërbime të tjera administrative në pajtim me ligjin dhe aktet e tjera normative të OMK-së.
2. Në rast të mospërbushjes së këtyre obligimeve organet e OMK-së marrin masa disiplinore ndaj anëtarëve të saj.

Neni 55

1. Mjetet e OMK-së derdhen në xhirollogarinë e OMK-së dhe menaxhohen sipas nenit 41 të Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë.
2. Kryetari i OMK-së është përgjegjës financiar i OMK-së.
3. OMK-ja është përgjegjëse për punën e saj dhe për tërë pasurinë që ka në dispozicion.

Neni 56

1. OMK-ja hap llogari (nënkod) të veçantë, menaxhon mjetet e dedikuara në Fondin e solidaritetit dhe ndihmës reciproke të anëtarëve të OMK-së.
2. Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të përdoren për ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë të anëtarëve të OMK-së, dhe të anëtarëve të familjes së tyre në rast fatkeqësie, të cilat rregullohen me akte të veçanta.
3. Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të dedikohen edhe për sigurim të pasurisë së OMK-së, aftësimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të OMK-së në pajtim me këtë ligj dhe Statutin, si dhe aktet e tjera të OMK-së.

Neni 57

Mjetet nga donacionet dhe dhuratat duhet të përdoren në pajtueshmëri me destinacionin, në të kundërtën duhet të shfrytëzohen në përputhshmëri me Ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë, Statutin e OMK-së dhe aktet e veçanta për menaxhimin e të hyrave të OMK-së.

Neni 58

Me akt të veçantë të OMK-së do të përcaktohet lartësia e anëtarësisë për anëtarët e OMK-së, taksës për licencim dhe rilicencim, si dhe e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve të tjera për të cilat OMK-ja mban evidencë zyrtare.

VII. TRANSPARENCA E PUNËS SË ODËS

Neni 59

1. OMK-ja obligohet që ta njoftojë opinionin mbi çështjet që i konsideron të rëndësishme nga fushëveprimi i OMK-së.
2. OMK-ja ka për obligim të njoftojë organet kompetente të ndjekjes, organet kompetente gjyqësore dhe Ministrinë e Shëndetësisë për procedurat disiplinore që udhëhiqen ndaj anëtarëve të

OMK-së nga organet e OMK-së, si dhe procedurën e licencimit, rilicencimit dhe revokimit të licencës, nëse dyshohet se në këto procedura ekziston dyshimi i bazuar që është kryer vepër penale.

3. OMK-ja ka për obligim që me kërkesë të organeve nga paragrafi 2 i këtij neni t'i verë në dispozicion të gjitha faktet dhe informatat që posedon.

Neni 60

OMK-ja bashkëpunon me institucionet arsimore të profilit shëndetësor, institucionet shëndetësore, shoqatat e profesionistëve shëndetësorë, fondin e sigurimeve shëndetësore, lidhur me çështjet e rëndësishme për punët e OMK-së, dhe të mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve.

Neni 61

1. Mbledhjet e Kuvendit dhe organeve tjera të OMK-së janë të hapura për publikun.

2. Kuvendi i OMK-së apo organi tjetër i saj mund të vendosë për përjashtimin e publikut nga i tërë takimi apo nga një pjesë e tij në rastet kur takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione, të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare, si dhe informacione të ndjeshme personale apo komerciale dhe akteve të tjera ligjore.

3. Njoftimet për takimin e Kuvendit bëhen publike.

4. Me Rregulloren mbi Punën e Kuvendit parashihet procedura e njoftimeve publike për takimet e Kuvendit dhe organeve të tjera.

5. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal ku shënohen data, vendi i mbledhjes, pjesëmarrësit, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma e rezultati i votimit, i cili miratohet në mbledhjen e radhës.

Neni 62

Komisioni Statutor

(Ndryshuar me Vendimin nr. 47/2018 të Kuvendit të OMK-së, datës 10 janar 2018)

1. Komisioni Statutor është organ i themeluar në bazë të Statutit të OMK-së, i cili ka kompetencë ekskluzive për interpretimin përfundimtar të dispozitave statutore.
2. Komisioni Statutor përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi i OMK-së. Kuvendi i OMK-së zgjedh anëtarët e Komisionit Statutor nga radhët e anëtarëve të Kuvendit sipas mënyrës së përcaktuar me Rregulloren për procedurat e kandidimit dhe mënyrës së zgjedhjes të anëtarëve në organet e OMK-së.

3. Komisioni Statutor ka kryetarin dhe zëvendëskryetarin, të cilët zgjidhen nga anëtarët e Komisionit.
4. Anëtarët e Komisionit Statutor nuk mund të jenë anëtarë të ndonjë organi tjetër të OMK-së dhe të njëjtit ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë të pavarur.
5. Komisioni Statutor vendos për kërkesat dhe ankesat e parashtruara nga anëtarët e OMK-së lidhur me interpretimin e normave statusore, si dhe përputhshmërinë e akteve normative, vendimeve dhe akteve të tjera të organeve të OMK-së me Statutin e OMK-së.
6. Vendimet dhe aktet e Kuvendit të OMK-së, të cilat miratohen me 2/3 e anëtarëve të Kuvendit nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit të Komisionit Statutor të OMK-së.
7. Rregullimi procedural dhe funksional rregullohet me Rregulloren e brendshme të punës, e cila duhet të miratohet nga 2/3 e anëtarëve të Komisionit.

VIII. MBIKËQYRJA E PUNËS SË ODËS

Neni 63

1. Mbiqëqyrjen ndaj ligjshmërisë së punës së OMK-së në ushtrimin e funksioneve publike nga neni 9 i Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë e bën Ministria e Shëndetësisë.
2. Në ushtrimin e mbiqëqyrjes nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria e Shëndetësisë mund të kërkojë nga organet e OMK-së raport dhe informata për çështje të caktuara.
3. OMK-ja është e obliguar që raportet dhe informatat nga paragrafi 2 i këtij neni t'ia ofrojë Ministrisë së Shëndetësisë në afat prej 30 ditësh nga dita e kërkesës, ose të informojë mbi arsyet për të cilat nuk është e mundur të i dërgojë brenda afatit të kërkuar.
4. OMK-ja është e obliguar që gjer më 31 mars të vitit vijues t'ia dërgojë Ministrisë së Shëndetësisë raportin vjetor për vitin paraprak.

Neni 64

Për financimin e aktiviteteve dhe raportimeve financiare të OMK-së duhet të zbatohen rregullat e afarizmit dhe të kontabilitetit që i bën Ministria e Financave.

IX. AKTET E PËRGJITHSHME TË OMK-së

Neni 65

1. Aktet e përgjithshme të OMK-së janë: Statuti, Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, rregulloret e ndryshme, udhëzimet dhe vendimet e tjera të organeve të OMK-së, që kanë të bëjnë me çështje të përgjithshme.
2. Aktet e përgjithshme të OMK-së duhet të jenë në pajtim me legjislacionin në fuqi, në Republikën e Kosovës.
3. Iniciativën për nxjerrje dhe ndryshim të akteve të përgjithshme të OMK-së mund ta marrin organet e OMK-së dhe shoqatat profesionale mjekësore.
4. Miratimit nga Kuvendi të akteve të përgjithshme të OMK-së duhet t'i paraprijnë debati publik me komunitetin mjekësor.

X. SHËRBIMI PROFESIONAL I OMK-së

Neni 66

Zyra Administrative ushtron veprimtaritë e mëposhtme:

1. Ushtrimin e detyrave administrative dhe profesionale;
2. Regjistrimin, licencimin, si dhe autorizimin e mjekëve që nuk janë anëtarë të OMK-së;
3. Mbajtjen e regjistrit të mjekëve;
4. Aktivitete të tjera që OMK-ja mund t'ia delegojë Zyrës Administrative;
5. Ushtron edhe detyra të tjera administrative nga nenet 9 dhe 10 të Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë.

Neni 67

1. Organizimi dhe puna e Zyrës Administrative përcaktohet me akte të veçanta për organizimin dhe sistematizimin e punëve të miratuara nga Kuvendi i OMK-së.
2. Të punësuarit në Zyrën Administrative të OMK-së i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet të përcaktuara me Ligjin e punës, këtë Statut dhe aktet e tjera të OMK-së.
3. Punën e Zyrës Administrative e udhëheq sekretari i përgjithshëm i OMK-së.
4. Sekretarin e përgjithshëm të OMK-së e zgjedh Këshilli Drejtues i OMK-së në bazë të konkursit publik.

Neni 68

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet Statuti i përkohshëm i miratuar nga ministri i Shëndetësisë më dt. 11 tetor 2013.

XI. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 69

Ky Statut hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas nënshkrimit nga ministri i Shëndetësisë dhe kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës.

Prishtinë, 26 janar 2015 - Plotësimet dhe ndryshimet e miratuara - 10 janar 2018, 17 janar 2019 si dhe 27 janar 2022.

Kryetari i OMK-së

Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci

Dt. 28 Janar 2022

Ministri i Shëndetësisë

Prof. Dr. Rifat Latifi